

## **Rregullamenti per hyrjen ne internet ne Biblioteken Komunale te Faenzes dhe tek Informagiovani (LINGUA ALBANESE)**

Rregullamenti prezent duhet zbatuar per te hyre ne Internet neper vendet fikse vene ne dispozicion nga Biblioteka dhe nga Informagiovani (sherbim informues per te rinjte) dhe ne vendet jo fikse (kompjuter portabel,palmar,celular, etj.) prone e juaja,ne menyre WiFi (Wireless Fidelity).

### **Art.1- Obiektivi i sherbimit**

Sherbimi ka si objektivi:

- shperndarjen e dijës nepermjet perdorimit te teknologjive te reja
- forcimin e hyrjes ne rrjet nga ana e qytetareve duke shperndare informacione dhe njohje dhe per te lehtesuar studimin,kerkimin dhe dokumentacionin.

### **Art.2- Pershkrimi i sherbimit**

Sherbimi mundeson lidhjen e perkohshme ne Internet, ne respekt te ligjit qe e mbron dhe obiectiveve publike te sherbimit.

Sherbimi eshte aktiv gjate orareve te hapjes se Bibliotekes dhe te Informagiovani; jashte ketyre orareve sherbimi nuk eshte aktiv.

Sherbimi eshte falas.

### **Art.3- Kushtet dhe menyra per te perdorur sherbimin**

Per te hyre ne rrjet dhe per te lundruar, si nga vende fikse dhe jo fikse, eshte e nevojshme dhe e detyruar rregjistrimi per te patur elementet e nevojshem per hyrjen.

Limiti per te lundruar eshte dy ore ne dite.

Qytetari qe i nevojitet ky sherbim duhet te jete mbi 18-vjec dhe duhet te paraqisi nje dokument identiteti te vlefshem.

Qytetaret nen 18-vjec per tu rregjistruar duhet te shoqerohen nga nje prind o nga kush kujdeset per ta ,me nje dokument identiteti te vlefshem. Prindri duhet te firmose nje modular me te cilin autorizon minorenin te lundroje ne rrjet pa prezencen e tij.

Lundrimi ne menyre WiFi ne zonat e mbuluara nga sherbimi eshte i lire nepermjet strumenteve te hyrjes prone e juaja, mbasi jeni identifikuar me elementet qe sherbejne per te hyre qe ju jane dhene ne momentin e rregjistrimit.

Per sa i perket menyres se perdorimit te vendeve fikse:

- qytetari ,para se te beje lidhjen duhet ti kerkoje punonjesit ne c'vend te hyje;
- ne te njejtin vend nuk mund te hyjne me shume se dy vete njekohesisht;
- qytetari duhet te identifikohet (login) dhe te shlidhet nga rrjeti (logout) para cdo dalje ;
- qytetari mund te perdore vendin per jo me shume se nje ore;
- ne mbarim te ores qytetari duhet te dale nga vendi menjehere,ne rast te kunder punonjesi ka te drejte te bllokoje vendin;
- nuk jane te lejuara shkarkimi i informacioneve dhe stampime qe kerkojne me shume kohe se nje ore .

Nuk eshte parashikuar ndihma teknike nga ana e punonjesve te Bibliotekes dhe sherbimi i stampimeve ne menyre wireless.

### **Art. 4- rregulla te sjelljes te qytetarit**

Qytetari eshte responsabili direkt i aktivitetit qe zhvillon gjate lidhjes ne Internet.

Elementet per hyrjen ne Internet (username e password) jane personale dhe nuk mund te jepen personave te tjere; qytetari eshte responsabel nese keto nuk perdoren korektesisht .

Gjate perdorimit te Internetit eshte e ndaluar:

- te shkarkosh (download) file degjimi dhe video;
- te hysh ne site qe jane ne kontrast me obiectivat publike te sherbimit (site pedoflike,pornografike,qe nxisin dhunen,rracizem,drogen,etj.);

- zhvillimi i cfaredoltoj aktiviteti per te mashtruar sistemet e kontrollit te hyrjes apo te mbrojtjes te cfaredoltoj kompjuteri te brendesem apo publik;

- perdorimi i mekanizmave teknologjike o di cfaredoltoj natyre,veprime per te mashtruar mbrojtjesit qe mbrojne nga kopiet fallso,qe zbulojne password dhe identifikojne dobesite e sigurise te sistemit,deshifrimin e file-ve te bllokuara qe vene ne rrezik sigurine e rrjetit ne cfaredoltoj menyre;

- zhvillimi i cfaredoltoj aktiviteti qe eshte ne kontrast me rregullat italiane dhe europiane.

Punonjesi ne sherbim nuk eshte ne asnje menyre responsabel per permbajtjen,kualitetin dhe vleren e cfaredoltoj informacioni te gjetur ne rrjet.

Qytetari merr persiper te gjithë responsabilitetin per veprimet e bera gjate perdorimit te Internetit dhe per permbajtjen e mesazheve te derguara e duhet te evitoje veprime qe mund te bezdisin te tjeret( hapje imazhezh,degjim i muzikes pa kufie,lojra ne rrjet,telefonata virtuale,etj.)

Qytetari duhet te vezhgoj ligjet per te drejtat e autorit dhe mbrojtjen e privatit (privacy),gjithashtu rregullat qe perndjekin penalisht ne sektorin informatik dhe ne komunikacionin elektronik, cfaredoltoj ligji tjeter ne gjenerale.

### **Art.5- Monitorimi i aktivitetit**

Punonjesi ne sherbim mban gjurmë te informacioneve (file log) dhe te aktivitetit te zhvilluar nga qytetari gjate lidhjes ne Internet simbas rregullave dhe kohes te parashikuara nga rregullamenti. Simbas ligjit ne fuqi,informacionet e juaja personale mund ti jepen sherbimit te policise postale dhe te komunikimit (Servizio di Polizia Postale e delle Comunicazioni), autoritetit dhe policise gjykuese (Autorità Giudiziaria e alla Polizia Giudiziaria) nese keto do ti kerkojne.

### **Art.6- Denime**

Ne rast se rregullat e mesiper do te thyhen,punonjesi i Bibliotokes ka te drejte:

- te bllokoje lidhjen dhe te urdheroje qytetarin te braktise vendin menjehere;
- te mos lejoje me ne te ardhmen qe qytetari te perdore sherbimin,nderprerja do konfirmohet me nderhyrjen e Drejtorit te Sektorit Kultura –Istruzione, i cili do vendosi kohen (nga 15-60 dite simbas demit)

Ne rast demit me te madh Drejtori mund te vendose heqen perfundimtare te sherbimit.

Drejtori i Sektorit Kultura-Istruzione mund te vendose ,neqoftese egzistojne prova te qarta:

- gjoba ekonomike per deme te provokuara sepse nuk eshte respektuar rregullamenti apo sepse jane demtuar mjetet informatike.
- Denoncim tek Autoritetet e Mbrojtjes Publike.

### **Art. 7- Rregullime dhe rinisje**

Sherbimi i Bibliotekes ka te drejte te rregulloje kushtet gjenerale prezente dhe kushtet per cdo sherbim te vetem,me paralajmerim te pakten 30 dite komunikuar ne murin virtual (home page) te Bibliotekes Komunale ne adresen <http://www.racine.ra.it/manfrediana>, mbasi kalon periudha e paralajmerimit,kushtet e reja konsiderohen te pranuar dhe te vlefshme perballë qytetarit,pervec atyre rasteve kur qytetari kerkon te terhiqet ne cfaredo momenti.

Persa i perket gjerave te pathena do merret parasysh ligji ne fuqi.

### **Art. 8- Ligjet ku mbeshtetemi**

Dekreti Legjislativ n.196/2003 “Kodi i mbrojtjes te datave personale”

Dekreti Legjislativ n.259/2003 “Kodi komunikimit elektronik”

Dekreti –ligj n.144/2005, rirregulluar nga ligji 31 korrikut 2005,n.155 “Masa urgjente kunder terrorizmit internacional”

*Aprovuar ne mbledhjen e Komunes n.29,me 8/2/2011*

**Si ringrazia per la traduzione Adriana Cela.**